

A K T T H E M E L I M I
PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BE-EN" SH.P.K. LEZHE

Ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte Arben Mhilli, i biri i Ndues, i vitlindjes 1966, lindur dhe banues ne qytetin Lezhe, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

N e n i 1

Themeluesi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **ortaku i vetem** emerton shoqerine me emrin "BE-EN" sh.p.k.

N e n i 2

Selia e kesaj shoqerie do te jete ne qytetin Lezhe, lagja "Beslidhja".

N e n i 3

Kohzgjatja e shoqerise do te jete mbi 15 vjet, me te drejte shtimi te ketij efati.

N e n i 4

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 leke dhe administrohet nga ortaku i vetem.

N e n i 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise "BE-EN" eshte prodhim, perpunim, shitblerje te lendes drusore, material ndertimor, hidroteknike, dhe veprimtari ndertimore, tregtim te artakujve industrial, ushqimor, elektroshtepiak, (drithra buke), bime medicinale, veprimtari komisionere, tregtim mjete transporti, pjese kembimi, material rikupero me shumice e pakice eksport - import dhe riparim automjesh.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
Arben Ndue Mhilli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

 Nr. 468 rep.
Nr. 165 kol.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me daten 27.1.1995 ne zyren e noterise Tirane, para ~~mijes~~ noteres se ketij qyteti u paraqit personalisht Arben Mhilli, banues ne Lezhe, madhor, me zotesi te plote per te vepruar per identitetin e te cilit u sigurova bga Leter Njoftimi personal me numur 227039 i cili deklaroi se ky akt themelim eshte me vullnetin e tij te lire e te plote dhe une noteria e vertetoj ate rregullisht s-

STATUTI

I SHOQERISE TREGTARE "BE-EN" sh.p.k; LEZHE.

Kreu I.

EMERTIMI; SELIA, KOHZGJATJA, OBJEKTI.

N e n i 1.

Shoqeria tregëtare "BE-EN" sh.p.k. Lezhe krijohet mbi baze të ligjit nr. 7512 date 10.8.1991 "Per sanksionim dhe mbrojtjen e pronës private, të pavarur, dhe të privatizimit" dhe ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqëritë tregëtare" shoqëria me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "BE-EN" sh.p.k.

Neni 2.

Selia e shoqërisë është në lagjen "Beslidhja" qyteti Lezhe. Me vendim të administratorit shoqëria mund të krijojë filiale, përfshirë të angjensit në qytet, të tjera të vendit si dhe jashtë vendit. Filialet e ndodhura në Shqipëri veprojnë sipas legjislacionit Shqipëtar ndërsa ato jashtë vendit sipas legjislacionit ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

N e n i 3.

Shoqëria "BE-EN" sh.p.k. është person juridik Shqipëtar. Kjo shoqëri fiton personalitetin juridik nga dita e rregjistrimit të saj në rregjistrin tregtar në gjykatën e rrethit Tiranë. Kjo shoqëri ka vulën e saj me formë e madhësi të zakonshme dhe me inisialët perkatese.

Neni 4.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është, prodhim, përpunim, shitblerje të lëndës drusore, veprimtari ndërtimore (material ndërtimor), materiale hidroteknike, tregtim të artikujve industrial, ushqimor, elektroshtepiak, bujqësor (dritëra buke), bime medicinale, veprimtari komisionere, tregtim mjete transporti, pjesë këmbimi, materiale rikupero me pakice dhe shumice, eksport-import dhe riparim automjeteve.

Neni 5.

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 15 vjet, me të drejtë shtimi të kësaj afati me përjashtim të rasteve kur vendoset kurrë shpërndarja e saj nga organi kompetent si dhe në rastin kur verifikohen rrethana të tilla që shpërndarja e saj parashikohet shprehimisht nga ligji.

Kreu II.

KAPITALI THEMELOR I SHOQERISE

Neni 6.

Kapitali themelor i shoqërisë është 100.000 leke. Ky kapital me vendim të ortakut të vetëm mund të shtohet. Kapitali themelor mund të jetë në të holla ose nga kontributi në natyrë, të cilat vlerësohen nga një ekspert i emëruar nga ortakut i vetëm. Nuk lejohej që kapitali i shoqërisë të përfqesohet nga letra me vlerë të tregtueshme apo shtetërisht. Ky kapital është tërësisht i shlyerë prej ortakut të vetëm.

Kreu III.

ORGANET E SHOQERISE

Neni 7.

Ortakut i vetëm është organi më i lartë i shoqërisë. Vendimet



e tij rregjistrohen ne librin e shoqerise.

Neni 8.

I takon ortakut te vetem e drejta e ndryshimit te neneve te statuterit, per rritjen e paksimin e kapitalit te shoqerise, per caktimin e perfundimit te shoqerise, per shperndarjen dhe per kohzgjatjen e saj, ndryshimin e selise, krijimin e filialeve dhe shkrirjen e tyre, marrjen e kredive, miratimin e pageses se punonjeseve dhe qdo qeshtje tjeter qe e gjykon te arsyeshme.

Neni 9.

Te gjitha te drejtat qe i takojne asamblese se ortakëve sipas ligjit "per shoqerine tregtare" i takojne ortakut te vetem.

Neni 10.

Mardhenjet e punes si pranimet, dhe largimet nga puna, masat disiplinore, paga dhe shperblimet, qdementimet, dhe probleme te tjera rregullohen nga kontratat individuale me te punesuarit dhe me kontraten kolektive, ne baze te ligjislacionit te punes ne Republiken e Shqiperise.

Kreu IV.

ADMINISTRIMI

Neni 11.

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem qe eshte z. Arben Mhilli, i biri i Ngues, i vit lindjes 1966, lindur e banues ne Lezhe, madhor, me zotesi per te vepruar.

Neni 12.

Mandati i administrimit eshte per 10 vjet, me te drejte rizgjedhje.

Neni 13.

Administratori ka te drejte te kryej qdo veprimtari administrative ne interes te shoqerise brenda objektit te veprimtarise se saj, ne mardhenje me te tretet, me perjashtim te atyre rasteve, kur ligji ne menyre ekskluzive i ka caktuar asamblese se ortakve qe ne rastin e dhene ushtrohet nga ortakut i vetem.

Neni 14.

Shoqeria merr persiper te drejta dhe detyrime qe rrjedhin nga aktet e administratorit kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 15.

Administratori takon firma e shoqerise dhe perfundesimi i saj ndaj te treteve.

Neni 16.

I ndalohej administratorit te kontraktoje me shoqerine e tij ne qdo forme.

Kreu V.

BILANCI DHE TE ARDHURAT E SHOQERISE

Neni 17.

Shoqeria tregtare "BE+EH" sh.p.k ka llogarine e saj rrjedhese ne nje ose disa nga Bankat qe funksionojne ne Republiken e Shqiperise.

Neni 18.

Ortakut i vetem emron nje ose disa ekspert kontabel te cilet kane per detyre te nxjerrin bilancin ne afatet e percaktuara (mujo, tremujor e vjetor), te plotesoje te gjitha detyrimet ndaj shtetit dhe organeve shtetore. Ne fund te qdo viti financiar paraqesin bilancin dhe fitimin.

Neni 19.

[Signature]

Neni 19
Viti financiar mbyllet çdo 31 dhjetor. Ortaku i shoqërisë ka
drejten ekskluzive mbi fitimet e shoqërisë.

Neni 20.
Shpërberja ose likuidimi i shoqërisë "BE-EN" sh.p.k. bëhet në
përputhje me ligjislacionin shqiptar për detyrimet ndaj shtetit dhe të
të treta. Shpërberja e shoqërisë mund të vijë për çdo shkak dhe në çdo
kohë.

Neni 21.
Administratori vendos për menyrën e likuidimit të shoqërisë dhe cak-
ton një ose më shumë likuidatorë duke u vënë atyre detyra konkrete. Likui-
datorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë deri sa ajo
të dorëzohet personave përkatës fizik ose juridik duke likuiduar në radhë
të parë detyrimet ndaj të treta.

Neni 22.
Ky statut hyn në fuqi ditën e fitimit të personalitetit të shoqërisë
"BE - EN" sh.p.k. Lezhe.

Shtypet në katër kopje, një nga të cilat mbahet në dokumentet e
shoqërisë, ndërsa kopjet e tjera depozitohen pranë organeve kompetente.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË

ARBEN NDUE MHILLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË

Nr. 408 rep.
Nr. 166 kol.

V E R T E T I M

Sot me datën 27 janar 1995 në zyrën e noterisë të qytetit
Tiranë, para meje notere e këtij qyteti u paraqit personalisht Arben
Ndue Mhilli, banues në Lezhë, për identitetin e të cilit u sigurova
nga letërnjoftimi personal me numër 227039; madhor me zotësi të plote
për të vepruar, i cili më deklaroi se ky statut është bërë me vullnetin
e tij të lirë e të plote dhe pa kushte të tjera të cilin une noterja
pasi e shoh konforme ligjit e firmos atë rregullisht sipas ligjit.

N O T O R E

Francis Korpçi

